

Shoqeria "RA-MI KOMPANI" SHPK

Shenime Pasqyra Financiare periudha 1 Janar -31 Dhjetor 2019

I. Kuadri Kontabel i Aplikuar.

Pasqyrat financiare te periudhes 01.Janar.2019-31.Dhjetor.2019, ne perberje te cilave jane Bilanci, Pasqyra e te Ardhurave dhe Shpenzimeve, Pasqyra e Fluksit te Parase, Pasqyra e Ndryshimeve ne Kapital ne datat e mesiperme jane pergatitur ne baze te kerkesave te Ligjit nr.25/2018 date 10.05.2018 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe Standartet Kombetare te Kontabilitetit te vendit tone.

Bilanci ne perberje te pasqyrave financiare tregon pozicionin financiar (aktivet, pasivet dhe kapitalin) te Shoqerise "RA-MI KOMPANI" shpk me date 31.12.2019.

Pasqyra e te Ardhurave dhe Shpenzimeve tregon performancen ekonomike (te ardhurat, shpenzimet dhe fitim/humbjen) te Shoqerise "RA-MI KOMPANI" shpk per periudhen 01.01.2019-31.12.2019.

Pasqyra e fluksit monetar tregon fluksin e parave (Arketimet dhe pagesat ne para dhe ekuivalentet e saj) te Shoqerise "RA-MI KOMPANI" shpk per periudhen 01.01.2019-31.12.2019.

Pasqyra e ndryshimeve ne kapital tregon ndryshimet ne kapitalin e Shoqerise "RA-MI KOMPANI" shpk shpk per periudhen 01.01.2019-31.12.2019.

I. Informacione te Pergjithshme

1.1 Të dhëna për Shoqërinë

Shoqeria "RA-MI KOMPANI" sh.p.k. eshte regjistruar me date 27.01.2016 nga QKR Tirane si shoqeri tregtare.

Selia aktuale eshte TIRANE Njesia Bashkiake nr.3, Rruga "Tele Ndini", Pallati nr.1, kati 1.

Kapitali themeltar i shoqerise eshte prej 100,000 leke dhe zoterohet nga Ortaket Albion Bushi 100%.

Objekti i veprimtarise se Shoqerise eshte Tregtimi me shumice e pakice, import-eksport i mallrave te ndryshme. Import Export, shitje me shumice dhe pakice e mjeteve te transportit te kapaciteteve ndryshme qe sherbejne per transportin e mallrave dhe/ose te pasagjereve. Eksport import, shitja me shumice dhe pakice e mjeteve bujqesore me ose pa zinxhire, te kapaciteteve te ndryshme, me ose parimorkio, makineri e pajisje industriale. Eksport-import, shitja me shumice dhe pakice e te gjitha llojeve te pjeseve te kembimit, gomave te automjeteve dhe te mjeteve bujqesore, baterive. Hapje dhe shfrytezim i serviseve per riparimin dhe mirembajtjen e te gjitha llojeve te mjeteve, hapje pika lavazhi. Investime dhe sherbime ne fushen e pasurive tepalujtshme, duke perfshire pa u kufizuar, shitje, qiradhenie, riparime, blerje, rimarrje te pasurive te patundshme ne Shqiperi. Kontrolli teknik dhe periodik i automjeteve te kapaciteteve te ndryshme qe perdoren per transportin e pasagjereve ose te mallrave, te mjeteve bujqesore me ose pa zinxhire. Shitja me pakice e lendeve djegese (nafte, benzine, lubrifikante, etj). Administrimi i pikave te karburantit per shitje me pakice ne territorin shqiptar. Transporti i lendeve djegese brenda dhe jashte vendit me mjetet e shoqerise ose te treteve. Hapja administrimi i pikave te karburantit dhe te mini-dyqaneve per tregtimin e aksesoreve te te gjitha llojeve te automjeteve. Aktivitet ne fushen e turizmit, hotelrise, bar, restaurant, internet-kafe. Import-eksport i mallrave te ndryshem industriale dhe ushqimore dhe perdorim shtepiak si: detergjente, tregtim i te gjitha materialeve, veshmbathje, tuba rekordi, elektropompa dhe mirembajtja e tyre etj. me shumice dhe pakice, te artikujve

Shoqëria "RA-MI KOMPANI" SHPK

Shenime Pasqyra Financiare periudha 1 Janar -31 Dhjetor 2019

kancelarie te te gjitha llojeve, pajisje kompjuterike te te gjitha llojeve. Tregtim pajisje elektrike dhe elektronike si dhe shërbimin për to, prodhim dhe tregtim të materialeve të ndërtimit, ndërtimin e objekteve me karakter social e publik, investime në fushën e ndërtimit etj. Zbatime punimesh ndërtimi, konsulence, supervision dhe kolaudim punimesh. Tregtim me shumicë dhe pakicë të të gjitha produkteve bujqësore, punime të ndryshme në bujqësi (mbjellje ,korrje , shirje etj.), transport i produkteve bujqësore. Shpime me sonde, import-eksport, makineri e pajisje transporti, pjesë këmbimi për makineri dhe pajisje të ndryshme, mallra dhe pajisje elektrike, elektro-shtëpiake të të gjitha llojeve, tregti me shumicë dhe pakicë të artikujve të ndryshëm industrial etj. Internet caffè, Bar - Restorant, Hoteleri Turizem etj. Në fushën e prodhimeve të ndërtimit: Prodhim dhe tregtime të materialeve, prodhim dhe tregtimi i betoneve të ndryshme, parafabrikate dhe elemente të ndërtimit, prodhimin e elementeve gjysem fabrikat, prodhim dhe tregtim i dyerve dhe dritareve prej druri dhe duralumini, të drejtën e franshionimeve të zhavorreve etj. Veprimtari në fushën e ndërtimit si ndërtime civile, ndërtime industrial, turistike, bujqësore etj. Veprimtari në fushën e turizmit, transportit, industrisë, në përpunimin e tregtimin e lendeve djegëse etj. Shoqëria, brenda caqeve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, do të kryejë çdo operacion tregtar e financiar që lidhet drejtperdrejt ose terthorazi me objektin e saj. Shoqëria mund të hapë veprimtari të reja, të krijojë sipërmarrje të reja ose të marrë pjesë në sipërmarrje të tjera si brenda ashtu dhe jashtë vendit pa cenuar objektin kryesor të shoqërisë dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

1.2. Baza e Përgatitjes

Ligji i ri i Kontabilitetit promovon zbatimin ligjor të standarteve nga shoqëritë.

Shoqëria ka vënë në zbatim aplikimin të Ligjit për Kontabilitetin për përgatitjen e Pasqyrave Financiare për periudhën ushtrimore që përfundon më 31 Dhjetor 2019.

Ato përfshijnë standartet e aprovuara nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit (KKK) dhe interpretimet e standarteve të shpallura nga Ministria e Financave.

Baza e përgatitjes së Pasqyrave Financiare: Të drejtat dhe detyrimet e konstatuara.(SKK 1,35)

Parimet dhe karakteristikat çesore të përdorura për hartimin e pasqyrave Financiare (SKK 1;37-69)

- a) NJESIA EKONOMIKE RAPORTUESE ka mbajtur në llogaritë e saj aktivet, pasivet dhe transaksionet ekonomike të veta.
- b) VIJMESIA e veprimtarisë ekonomike të njesisë sone raportuese është e siguar duke mos pasur në plan ose nevojë ndërprerjen e aktivitetit të saj.
- c) KOMPESIMI midis një aktivi dhe një pasivi nuk ka, ndërsa midis të ardhurave dhe shpenzimeve ka vetëm në rastet që lejohen nga SKK
- d) KUPTUSHMERIA e Pasqyrave Financiare është realizuar në masën e plote për të qenë të qarta dhe të kuptueshme për përdorues të jashtëm që kanë njohuri të përgjithshme të mjaftueshme në fushën e kontabilitetit.
- e) MATERIALITETI është vlerësuar nga ana jone dhe në baze të tij Pasqyrat Financiare janë hartuar vetëm për zërat materiale.
- f) BESUSHMERIA për hartimin e Pasqyrave Financiare është e siguar pasi nuk ka gabime materiale duke zbatuar parimet e mëposhtme :



Shoqëria "RA-MI KOMPANI" SHPK

Shenime Pasqyra Financiare periudha 1 Janar -31 Dhjetor 2019

- Parimin e paraqitjes me besnikëri
- Parimin e perparësise se permbajtjes ekonomike mbi formen ligjore
- Parimin e paaneshmerise pa asnje influencim te qellimshem
- Parimin e maturise pa optimizem te teperuar, pa nen e mbivleresim te qellimshem
- Parimin e plotesise duke paraqitur nje pamje te vertete e te drejte te PF.
- Parimin e qendrueshmerise per te mos ndryshuar politikat e metodat kontabel
- Parimin e krahasueshmerise duke siguruar krahasimin midis dy periudhave.

Rregullat e Vlerësimit dhe Paraqitjes së Llogarive Vjetore në Shqipëri janë përfshirë në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare të vitit 2019.

II . Politikat kryesore kontabile.

Nje permbledhje e pjeses me te madhe te politikave kontabel te aplikuara ne Pasqyrat financiare jane sa me poshte:

2.1. Mjetet Monetare.

Per Mjetet monetare ne arke dhe ne banke eshte aplikuar politika konatabel e vleresimit "Vlera e drejte", sipas paragrafit nr.22 te SKK-se nr.3.

Mjetet monetare ne monedha te huaja jane vleresuar ne monedhen baze me kursin e Bankes se Shqiperise qe daton 31.12.2019.

2.2. Aktivët e tjera financiare afatshkurtera.

Per Aktivët e Tjera financiare Afatshkurtra te paraqitura ne daten e mbylljes se bilancit 31.12.2019 eshte aplikuar politika konatabel e vleresimit "Kosto historike minus zhvleresimin e mundshem", sipas paragrafit nr.26,27 te SKK-se nr.3. Per vitin aktual vleresimi i tyre eshte bere me vleren nominale ne krijim te tyre.

2.3. Inventari

Per Inventarin e paraqitur ne daten e mbylljes se bilancit 31.12.2019 eshte aplikuar politika konatabel e vleresimit "Kosto historike", sipas paragrafit nr.14,15 te SKK-se nr.4.

Kosto eshte llogaritur duke perdorur Metoden e mesatares se ponderuar.

2.4. Huat dhe parapagimet.

Per Huat dhe parapagimet te paraqitura ne daten e mbylljes se bilancit 31.12.2019 eshte aplikuar politika konatabel e vleresimit "Kosto e amortizuar", sipas paragrafit nr.32,33 te SKK-se nr.3. Vlera nominale e huamarijeve afatshkurtra eshte amortizuar me kestet e likuidimit ne periudhe.

2.5. Kapitali

Vlera e kapitaleve dhe perberesve te tij eshte vleresuar me vleren e tyre historike kontabel. Ndryshimet ne grupin kapitale kane ardhur jo si rezultat i ndonje SKK-je.

2.6. Te Ardhurat dhe Shpenzimet.



Shoqeria "RA-MI KOMPANI" SHPK

Shenime Pasqyra Financiare periodua 1 Janar -31 Dhjetor 2019

Vleresimi i te Ardhurave dhe shpenzimeve eshte bere mbi bazen e parimit te konstatimit te drejtave dhe detyrimeve ne momentin e ndodhjes. Vleresimi i tyre eshte bere sipas percaktimeve ne paragrafet 35-37 te SKK-se nr.1 dhe te SKK-se nr.8.

Te ardhurat dhe shpenzimet klasifikohen sipas natyres dhe sipas funksioneve.

Të ardhurat përfshijnë të ardhurat nga shitjet neto dhe të ardhurat nga shërbimet të realizuara nga aktivitetet kryesore të shoqërisë, duke mos përfshirë tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH).

Pjesa më e madhe të shitjeve të shoqërisë gjenerohen nga shitja e mallrave.

Shpenzimet përfshijnë shpenzimet për materialet e konsumuara, si dhe nga shpenzimet e tjera rrjedhese me vleren ne momentin e ndodhjes (parimi i konstatimit te drejtave e detyrimeve)

2.7 Monedha funksionale dhe monedha e paraqitjes

Zërat e përfshirë në pasqyrat financiare vlerësohen duke përdorur monedhën e mjedisit ekonomik kryesor në të cilin operon njësi ("monedha funksionale"). Pasqyrat financiare paraqiten në Lekë (All), e cila është monedha funksionale dhe monedha e paraqitjes.

III. Informacion-Shtese per zerat Materiale.

3. Mjetet Monetare.

Mjetet monetare jane paraqitur ne bilanc sipas gjendjeve te llogarive bankare ne daten e fundit,31.12.2019, e cila eshte e njejte me ekstratet e fundit te bankave per kete periudhe si dhe me gjendjen e arkës së Shoqërisë në fund muajit Dhjetor 2019. Gjendjet sipas bankave dhe arkës paraqitet .

Gjendja e "Mjetet Monetare" me date 31 Dhjetor 2019 paraqitet:

Credins Bank ne Leke	153,033.04
Credins Bank ne Euro(39.54)	4,814,79
Procredit Bank ne Euro (19)	2,313.63
Credins Bank ne dollare(6.95)	755.05
Arka	483,601.49
SHUMA	644,518 Leke.

4. Aktivet e tjera financiare afatshkurtera.

Gjendja e "Aktiveve te tjera Financiare Afatshkurtera" me date 31 Dhjetor 2019 paraqitet per shumen **385,841,976 Leke** e cila perfaqson:

-Klientet te faturuar e te pa arketuar 31.12.2019 ne shumen **299,532,425 Leke.**

-Detyrime te tjera me 31.12.2019 ne shumen **86,309,551 leke.**


5. Inventaret.

Gjendja e "Inventareve" me date 31 Dhjetor 2019 ne paraqitet ne shumen **25,183,583 leke** sipas Inventarit bashkangjitur Pasqyrave Financiare.

Totali i Aktiveve afatshkurtera 411,670,077.

6. Aktivet afatgjata materiale.

Gjendja e "Aktivet afatgjata materiale" me date 31 Dhjetor 2019 paraqitet:



Shoqeria "RA-MI KOMPANI" SHPK

Shenime Pasqyra Financiare periudha 1 Janar -31 Dhjetor 2019

Nr	EMERTIMI	Nj.M	Sasia	V/fillestare	Am.akum uluar	Am. vjetor	Vl.e mbetur
1	Kondicioner	Cope	1	84,000	16,800		67,200
2	Kondicioner	Cope		182,000	3,033		178,967
				266,000	19,833		246,167
3	Kompjuter	Cope	1	42,292	7,049		35,243
4	Kompjuter	Cope	1	43,166	3,844		39,322
5	Kompjuter	Cope	1	26,250	0		26,250
6	Kompjuter	Cope	1	48,800	0		48,800
	Shuma Informatike			160,508	10,893		149,615
6	ATP Daimler	Cope	1	178,500	23,800		154,700
	Shuma Mj.Transporti			178,500	23,800		154,700
	SHUMA			605,008	54,526		550,482

7.Detyrimet afatshkurtera.

Te pagueshme ndaj furnitoreve	136,389,704
Te pagueshme ndaj punonjesve	0
Detyrimet Sig.shoqerore e TAP	233,772
Tatim ne Burim	8,550
Detyrime per Tatim Fitimin	523,838
Detyrime per TVSH-ne	2,382,259
Detyrime te tjera	130,269,035
Ortaku	18,102,760
Kredi Bankare afatshkurter	29,883,361
SHUMA	317,793,279

Detyrimet ndaj Furnitoreve perfaqsojne faturat e materialeve te blera dhe te palikujduara akoma me 31.12.2019.

Detyrimet ndaj TVSH-se, Sigurime shoqerore e shendetsores, Tap. e Tatim ne burim perfaqsojne detyrimet e paguara deri me 31.12.2019.

Detyrimet per tatim Fitimin per **523,838 leke** perfaqsojne Tatimin mbi Fitimin sipas Bilancit te vitit 2019 ne shumen 671,888 leke minus tatim fitimit e paguar paradhenie per vitin 2019 ne shumen 148,050 leke.

-Te tjera te pagueshme ne shumen **130,269,035 leke** perfaqsojne huate e tjera qe ka marre shoqeria per nevoja te aktivitetit te cilat do te shlyhen me krijimin e mundesive financiare.

-Ortake ne shumen 18,102,760 perfaqson financimin nga ortaket per nevoja te aktivitetit te cilat do te shlyhen me krijimin e gjendjes financiare.

Kredite bankare afatshkurtera ne shumen 29,883,361 leke perfaqsojne kredite e marra ne banka per nevoja te aktivitetit e te pashlyera deri me 31.12.2019.

Shoqeria "RA-MI KOMPANI" SHPK

Shenime Pasqyra Financiare periudha 1 Janar -31 Dhjetor 2019

8.Kapitali

Gjendja e grupit te Kapitaleve me date 31 Dhjetor 2019 paraqitet:

Kapitali	<u>31 Dhjetor 2019</u>
Kapitali Ortakerise	100,000
Primi i aksionit	
Njesite ose aksionet e thesarit	
Rezerva ligjore	10,000
Rezerva te tjera	153,210
Rezerva statuoore	
Fitimet e pashperndara	90,356,705
Fitimi/Humbja e vitit financiar	3,807,365
Totali	<u>94,427,280</u>

Kapitali ka ndryshime ne rritje vetem per fitimin neto te vitit 2019 ne per 3,807,365 leke.

9.Fitim/Humbja e Vitit Financiar.

Fitim/Humbja e Vitit Financiar 2019 eshte rezultante e Te ardhurave ushtrimore dhe Shpenzimeve ushtrimore. Ne pasqyren e meposhtme do te paraqitet formula e Fitim/Humbjes te Vitit Financiar 2019.

10.Të ardhurat

Për periudhën kontabël që mbyllet 01 Janar 2019-31 Dhjetor 2019 Shoqeria ka realizuar të ardhura të cilat rrjedhin nga shitja e mallrave shërbimet e kryera.

Te ardhurat e ushtrimit ne vleren 212,711,599 leke qe kane ardhur :

1.Nga shitja e mallrave e sherbimeve prej 212,711,599 leke

11.Shpenzime per Blerje Mallarsh

Shpenzimet per Materialet e konsumuara perfshijne shpenzimet per blerje e mallra gjate vitit 2019 duke shtuar inventarin ne fillim te vitit dhe duke zbritur inventarin ne fund te vitit si me poshte:

Blerje mallra e materiale gjithesej	183,679,793
+Gjendja e inventarit ne fillim	28,091,956
-Gjendja e inventarit ne fund	25,183,583
Materialet e konsumuara	186,588,166 Leke.

12. Shpenzimet e Personelit

Në shpenzimet për personelin, janë përfshirë shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore e shëndetësore vetem pjesa qe paguan punedhenesi.

Paga punonjesish	2,841,908
Sigurime shoq.e shend.	474,598
Shuma	3,316,506 Leke.

13.Shpenzime per amortizimin: Ne shumen 0 leke..

Shoqeria "RA-MI KOMPANI" SHPK

.....
Shenime Pasqyra Financiare periudha 1 Janar -31 Dhjetor 2019

14. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Në shpenzimet e tjera të shfrytëzimit në shumën **17,310,356 leke** janë përfshirë shërbimet e kryera nga të tretët si më poshtë:

Qera	228,000
Mirembajtje e riparime	278,958
Siguracione	78,625
Te tjera	933,954
Konsulencë financiare dhe ekspertizë	210,000
Udhëtim e diëta	384,375
Shpenzime postare e telefoni	669,097
Transport në blerje	14,212,491
Komisione bankare	204,024
Taksa doganore	110,832

15. Shpenzime Financiare:

Shpenzimet financiare në shumën **1,017,318 leke** përfaqësojnë shpenzime për Humbje nga këmbimet valutore.

16. Fitimi.

Te Ardhurat gjithësej **212,711,599.**

Shpenzimet gjithësej **208,232,346.**

Shoqeria për vitin 2019 ka rezultuar me fitim në shumën **4,479,253 leke**.

Tatim fitimi për vitin 2019 është **671,888 leke** ($4,479,253 \times 15\%$).

Fitimi neto i shoqërisë është **3,807,365 leke** ($4,479,253 - 671,888$).

17. Ngjarjet pas datës së bilancit kontabël

Ngjarje të tjera mbas bilancit, të cilat mund të kishin ndikim në rezultatin financiar të shoqërisë për periudhën Janar-Dhjetor 2019, nuk ka.

Hartuesi i Pasqyrave Financiare
Ekonomisti

Albion BUSHI



Per Drejtimin e Njesise Ekonomike
Administratori

Blerta NIKA



Tirane me 24 Mars 2020.

